

Nr. K1/I220-9 Prot.
Nr. Dok. 202401797/9

Tiranë, 02.09.2025

Lënda: Rekomandim mbi përmbushjen e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare të pakicës rome dhe nevojën për masa institucionale në zonën Mbrostar-Fier

BASHKISË FIER

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT (MAS)

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (DRAP) FIER

ZYRËS VENDORE ARSIMORE (ZVA) FIER

Institucioni i Avokatit të Popullit u vu në dijeni, përmes raportimeve mediatike, të rastit të një mësuesi nga pakicat rome në fshatin Mbrostar, Fier (Latif Kazanxhiu) i cili ka kthyer shtëpinë e tij në klasë për t'u mësuar fëmijëve gjuhën rome. Ky veprim erdhi si reagim ndaj shqetësimit se fëmijët romë po harrojnë gjuhën e tyre, sidomos shkrimin e saj, për shkak të mungesës së mësimdhënies së strukturuar në shkollë. Sipas kronikës së publikuar, z. Kazanxhiu, një nga mësuesit e parë të gjuhës rome në Shqipëri, shprehet se politika dhe institucionet arsimore nuk i kanë kushtuar vëmendjen e duhur kësaj pakice kombëtare, duke lënë jashtë vëmendjes nevojën për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditave të komunitetit rom. Në klasën e improvizuar në banesën e tij, z. Kazanxhiu u mëson rreth 23 fëmijëve romë shkrimin dhe leximin e gjuhës amtare. Ai ndjek një program mësimor të rregullt, të ngjashëm me atë të shkollave publike, me qëllim që fëmijët të përvetësojnë jo vetëm të folurin, por edhe shkrimin e gjuhës rome. Ky mësues rom shprehet krenar që, si rezultat i punës së tij shumëvjeçare, 17 të rinj të komunitetit rom në zonën Baltëz-Mbrostar kanë përfunduar arsimin e lartë dhe janë integruar më mirë në shoqëri. Sidoqoftë, ai ngre alarmin se gjuha rome po braktiset nga brezat e rinj – shumica e të rinjve romë ngurojnë ta flasin gjuhën e tyre, ndërsa shumë fëmijë dinë ta flasin por nuk dinë ta shkruajnë atë.

Në vijim kronika e plotë:

“Mësuesi kthen shtëpinë në shkollë për të mësuar Romishten: Po harrojmë ta shkruajmë, politika jo vëmendje ndaj nesh

Fëmijët romë po harrojnë gjuhën e tyre, sidomos shkrimin e saj. Një mësues në Fier, pjesë e këtij komuniteti, ka kthyer shtëpinë e tij në një klasë ku ju mëson vogëlushëve romishten. Latif Kazanxhiu akuzon partitë politike se nuk e kanë në vëmendje këtë minoritet. Fier- Latif Kazanxhiu prej më shumë se 20 vitesh përcjell tek brezat e rinj të komunitetit rom në Baltëz e Mbrostar të Fierit, dashurinë për gjuhën, kulturën dhe traditat e komunitetit rom. Ai është themeluesi i organizatës “Rom Aktiv Albania” dhe një ndër mësuesit e parë të gjuhës rome në Shqipëri, ndërsa dëshira e tij e hershme ka qenë që komuniteti rom të ketë përfshirje sociale dhe një qasje të barabartë, për të pushuar së qeni pjesë e marxhinalizuar në shoqëri. “Lidhur me arsimimin tim, prindërit kanë qenë ata që më kanë edukuar me frymën arsimdashëse, ndërsa tregon se gjuhën rome e kanë ruajtur vetëm në familje deri para viteve ‘90, ndërsa ndryshimi i sistemit na gjeti tërësisht të papërgatitur. Çdo parti politike kishte programin e vet, por komuniteti rom ishte jashtë vëmendjes së tyre. Në këto kushte u bëra nismëtar i organizatës “Rom Aktiv Albania” dhe mësova metodikën e gjuhës rome. Pas kësaj çdo ditë e jetës time ka qenë pranë fëmijëve romë për t’iu mësuar të shkruajnë e lexojnë gjuhën e nënës, por edhe për mbështetje shkollore në gjuhën shqip”, rrëfen ai. Kazanxhiu ndihet krenar teksa si rezultat i punës së tij 17 të rinj të komunitetet romë në Baltëz, kanë përfunduar studimet e larta dhe sot kërkojnë të angazhohen në administratë. Për të shqetësimi kryesor mbetet fakti se romishtja po harrohet, për shkak se shumica e tyre dinë vetëm ta flasin dhe jo ta shkruajnë, ndërsa të rinjtë hezitojnë edhe ta flasin. Në klasën e hapur në një ambient shtëpie në Mbrostar, sot numërohen rreth 23 nxënës. Këtu, mësuesi rom përpiqet t’i japë orës mësimore të gjithë elementët e të nxënësve, duke filluar nga një program pune i cili zbatohet me përpikëri si në çdo shkollë publike.”

Sa më sipër, duke vlerësuar se kjo situatë e bën të domosdoshme ndërhyrjen institucionale për ruajtjen e kësaj gjuhe minoritare, në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe veçanërisht të drejtave të pakicave kombëtare, si dhe në zbatim të nenit 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Avokati i Popullit ndërmoi një hetim me iniciativë për rastin e mësipërm.

Në kuadër të këtij hetimi, iu drejtuam me kërkesa zyrtare për informacion dhe shpjegime institucioneve përgjegjëse, konkretisht Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS); Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP); Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Fier si dhe Bashkisë Fier. Kërkesa kryesore drejtuar institucioneve ishte për të përcjellë informacion dhe shpjegime nëse ishin në dijeni të këtij rasti dhe të ofronin çdo shpjegim apo informacion të disponueshëm lidhur me ofrimin e mësimin në gjuhën rome në zonën në fjalë, përfshirë ndonjë hap apo procedurë zyrtare të ndërmarrë. Brenda afateve ligjore, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga institucionet arsimore qendrore dhe vendore, të cilat përmbledhen si vijon.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP) Fier, me shkresën nr. 66/1, datë 17.01.2025, informoi se pas marrjes së kërkesës sonë, DRAP Fier i ishte drejtuar zyrtarisht

Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) Fier për të verifikuar rastin. Nga përgjigja e ZVA Fier rezultoi se drejtorët e shkollave që mbulojnë zonat Baltëz dhe Mbrostar nuk kishin informacion mbi ndonjë klasë të hapur në komunitet ku mësohet gjuha rome. Nuk rezultonte të ishte paraqitur asnjë kërkesë zyrtare nga prindër, komuniteti apo organizata për zhvillimin e mësimin në gjuhën rome, dhe për rrjedhojë nuk ekziston dokumentacion lidhur me këtë çështje në institucionet arsimore publike të zonës. Gjithashtu, DRAP Fier sqaroi se z. Latif Kazanxhiu nuk figuron dhe as nuk ka figuruar ndonjëherë si mësues i punësuar në sistemin arsimor publik. Në përgjigje theksohet se hapja e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare realizohet vetëm sipas procedurave ligjore të parashikuara, që kërkojnë plotësimin e disa kriterëve (kualifikimi i mësuesit, infrastruktura shkollore, numri minimal i nxënësve, etj.) dhe miratim nga autoritetet kompetente. DRAP Fier shtoi se shkollat publike, kur janë të shpallura si qendra komunitare, mund të organizojnë veprimtari edukuese për ruajtjen e gjuhës dhe kulturës së komunitetit rom, por vetëm pasi interesi për këto veprimtari të jetë adresuar zyrtarisht pranë institucioneve arsimore nga vetë komuniteti ose prindërit e fëmijëve. Sipas DRAP Fier, gjatë vitit shkollor 2024-2025 nuk ka pasur asnjë kontakt apo kërkesë nga organizatat e shoqërisë civile apo nga aktorë të tjerë pranë ZVA Fier ose vetë DRAP, për të mundësuar mësim në gjuhën rome në institucionet arsimore publike.

Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), me shkresën nr. 179/1, datë 23.01.2025, konfirmoi angazhimin e saj për mbështetjen e arsimimit të fëmijëve të pakicave kombëtare, veçanërisht atyre të komunitetit rom, në kuadër të prioritetëve të integritetit evropian të vendit. Në përgjigjen e MAS nënvizohet se reformat legjislative, administrative dhe institucionale të ndërmarra deri më tani kanë synuar rritjen e përfshirjes së fëmijëve dhe të rinjve romë në arsim, duke garantuar barazi në akses dhe cilësi arsimore. Kjo reflektohet edhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, e cila ka ndër objektivat e saj eliminimin e çdo forme segregimi apo diskriminimi ndaj fëmijëve të pakicave rome dhe egjiptiane dhe promovimin e gjithëpërfshirjes. MAS bën me dije se aktualisht, në sistemin arsimor parauniversitar ofrohet mësim në gjuhën amtare për pakicat kombëtare greke dhe maqedonase (në zonat ku këto pakica banojnë në mënyrë të dendur dhe historike). Për shtatë pakicat e tjera të njohura zyrtarisht – përfshirë pakicën rome (si dhe ato arumune, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare) – deri tani nuk është realizuar mësimi në gjuhën amtare në shkolla, pasi kërkesat eventuale të paraqitura nuk kanë qenë në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar për arsimimin në gjuhën amtare. Ministria sjell në vëmendje se, sipas legjislacionit në fuqi, hapja e klasave ku mësohet në gjuhën e një pakice kombëtare mund të bëhet vetëm duke ndjekur procedurat dhe kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse. Konkretisht, për rastin e pakicës rome (dhe pakicave të tjera), MAS citon Vendimin nr. 1155, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, i cili përcakton kriteret dhe procedurat për arsimimin në gjuhën e pakicave kombëtare. Sipas këtij vendimi: (a) Iniciativa për hapjen e klasave të veçanta në gjuhën e pakicës mund të ndërmerret nga njësia e vetëqeverisjes vendore (bashkia), nga njësia arsimore vendore (ZVA/DRAP) ose nga vetë komuniteti i zonës ku kërkohet të hapen klasat; (b) Popullsia e pakicës kombëtare në njësinë administrative përkatëse duhet të jetë jo më pak se

20% e popullsisë totale të asaj njësie administrative, bazuar në regjistrimin zyrtar të popullsisë; (c) Duhet paraqitur një kërkesë e shkruar nga prindërit apo kujdestarët e fëmijëve të pakicës, ku shprehet vullneti i tyre (bazuar në parimin e vetëidentifikimit) për arsimimin e fëmijëve në gjuhën amtare; (d) Kryetari i bashkisë dhe titullari i zyrës arsimore vendore, pas konsultimit me përfaqësues të pakicës kombëtare përkatëse, i paraqesin një propozim zyrtar ministrit përgjegjës për arsimin për hapjen e klasave në gjuhën e pakicës; (e) Propozimi shoqërohet me një studim që argumenton domosdoshmërinë e hapjes së këtyre klasave (p.sh. numrin e fëmijëve që do të përfitojnë, kualifikimet e mundshme të mësuesve, mjediset ku do zhvillohet mësimi) si dhe me detajimin e kontributit të pushtetit vendor (p.sh. në infrastrukturë, logjistikë apo burime njerëzore). MAS vëren se këto mekanizma ligjorë ekzistojnë për t'u siguruar që ofrimi i arsimit në gjuhën e pakicave kryhet në mënyrë të planifikuar dhe të standardizuar, por nënkupton se në rastin e pakicës romë deri më tani nuk ka mbërritur ndonjë propozim i tillë zyrtar që të plotësonte kriteret e mësipërme. Ministria shton se, pavarësisht kësaj, shkollat si qendra komunitare mund të organizojnë aktivitete jashtëshkollore për ruajtjen e gjuhës dhe kulturës romë, kur ka interes dhe kërkesë të shprehur nga komuniteti, në bashkëpunim me njësitë vendore arsimore.

Bashkia Fier, deri në momentin e hartimit të këtij rekomandimi, nuk ka kthyer ende një përgjigje zyrtare në lidhje me kërkesën tonë për informacion. Kjo kërkesë i është dërguar fillimisht me shkresën nr. 202401797/7, datë 04.03.2025, dhe është përsëritur me shkresën nr. 202401797/8, datë 24.03.2025, pas kalimit të afatit pa asnjë përgjigje. Në shkresat drejtuar bashkisë, Avokati i Popullit ka kërkuar informacion dhe shpjegime nëse pushteti vendor ka kryer ndonjë vlerësim të nevojave arsimore të fëmijëve të komunitetit rom në Mbrostar e rrethinat, sidomos për mësimin e gjuhës amtare, dhe nëse ka pasur ndonjë iniciativë apo kërkesë nga komuniteti drejt bashkisë për këtë çështje.

Kuadri rregullator dhe analiza e rastit

E drejta e pakicave kombëtare për të ruajtur dhe mësuar gjuhën e tyre amtare njihet dhe mbrohet nga legjislacioni shqiptar dhe aktet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. Neni 20 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton se personat që i përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në mënyrë të lirë të drejtat e tyre, përfshirë të drejtën për të ruajtur gjuhën, traditat e kulturën. Kushtetuta ndalon çdo diskriminim për shkak të përkatësisë kombëtare dhe, në frymën e saj, kërkon nga shteti të krijojë kushte që pakicat të gëzojnë të drejtat kulturore e gjuhësore.

Ligji nr. 96/2017 “*Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë*” i cili për herë të parë në mënyrë gjithëpërfshirëse rregullon të drejtat e pakicave kombëtare, sanksionon të drejtën e personave që u përkasin pakicave për arsimim në gjuhën e tyre amtare. Në veçanti, ligji parashikon se në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku një pakicë përbën një pjesë të konsiderueshme të popullsisë (të paktën 20% sipas nenit 15 të ligjit), personave të asaj pakice

u njihet e drejta të mësojnë gjuhën e tyre në shkollë, në përputhje me ligjin për arsimin. Po ashtu, ligji përcakton parimin e vetëidentifikimit (askush nuk mund t'i imponohet fëmijës të deklarohej si pjesëtar i një pakice, por vetë prindi/kujdestari e deklaroi atë vullnetarisht) dhe kërkon marrjen e masave pozitive nga shteti për ruajtjen e identitetit gjuhësor e kulturor të pakicave.

Ligji nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”* (i ndryshuar) rregullon sistemin arsimor publik. Neni 9 i ligjit përcakton se në institucionet arsimore, gjuha e arsimimit është gjuha shqipe, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj, dhe më tej neni 10 i tij parashikon se personave, që u përkasin pakicave kombëtare, u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve mësimore. Për të mundësuar pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë, nxënësve të pakicave kombëtare u krijohen kushte për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e historisë e të kulturës shqiptare.

Kuadri i mësipërm ligjor plotësohet nga aktet nënligjore. Konkretisht, Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 561, datë 29.09.2018 “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve... si dhe për krijimin dhe funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare” përcaktoi për herë të parë mekanizmat konkrete për hapjen dhe funksionimin e klasave në gjuhët e pakicave. VKM-ja liston aktorët që mund të nisin propozimin (bashkia, zyra arsimore vendore, komuniteti lokal) dhe detajon se propozimi i paraqitet ministrit të Arsimit bashkërisht nga kryetari i bashkisë dhe drejtuesi vendor arsimor, pasi të jenë konsultuar me përfaqësues të pakicës. Po ashtu, VKM 561/2018 adreson çështje praktike si: pajisja me tekste shkollore në gjuhën e pakicës (me kosto falas për nxënësit, sikurse për tekstet e tjera bazë), formimi fillestar dhe trajnimi i mësuesve që do të japin lëndët në gjuhën e pakicës, financimi i tyre, etj. Ky vendim krijoi bazat e nevojshme që, sapo të ketë një kërkesë të vlefshme dhe të miratuar, sistemi arsimor të jetë i gatshëm ta zbatojë atë (p.sh. duke pasur mësues të trajnuar dhe tekste të hartuara). Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 1155, datë 24.12.2020 “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, të numrit thelbësor dhe të kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare” shërben si plotësues i VKM-së së mësipërme, duke qartësuar kriteret sasiore dhe procedurale. Tri kriteret kryesore të parashikuara, siç u përmend më lart, janë: pragu 20% i popullsisë së njësisë administrative që duhet t’i përkasë pakicës; regjistrimi në atë njësi (duke u mbështetur në të dhënat e gjendjes civile, për të konfirmuar se popullsia pakicë është rezidente aty historikisht, jo e ardhur rishtazi vetëm për qëllime arsimore); dhe kërkesa me shkrim e prindërve/kujdestarëve të fëmijëve pakicë për arsimim në gjuhën amtare. VKM 1155/2020 është në përputhje me parimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrotjen e Pakicave Kombëtare (ratifikuar nga Shqipëria), e cila lejon shtetet të vendosin kriteret objektive (si numri i mjaftueshëm) për zbatimin e të drejtave gjuhësore, por

njëkohësisht kërkon që këto kritere të mos e bëjnë të pamundur në praktikë ushtrimin e së drejtës.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe Plan i Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë reflektojnë angazhimin e Qeverisë Shqiptare për arsim gjithëpërfshirës.

Strategjia Kombëtare për Arsimin, ndonëse nuk përmend shprehimisht mësimin e gjuhës rome si një realitet aktual, vendos një bazë të qartë ligjore dhe institucionale për ofrimin e këtij mësimi. Ajo njeh të drejtën e pakicave për mësim në gjuhën amtare dhe përfshin masa konkrete si hartimi i programeve dhe teksteve shkollore. Megjithatë, strategjia tregon se në praktikë, disa pakica (si romët) mbeten të nënpërfaqësuar, sidomos në përfshirjen e gjuhës, historisë dhe kulturës së tyre në kurrikul duke theksuar se *“mësimi i historisë/kulturës së romëve dhe/ose migratëve nuk është i përfshirë sa duhet në lëndë të ndryshme shkollore, të tilla si: historia, edukimi qytetar ose shoqëror, letërsia, feja ose etika, arti, muzika ose gjuhët”* (fq. 37). Kështu, del në pah nevoja për zbatim më të plotë dhe të drejtë të dispozitave ekzistuese dhe për mbështetje shtesë për pakicat më të vogla, si pakica rome.

Plani i Veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve gjithashtu parashikon masa në fushën e arsimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ruajtjes së gjuhës dhe identitetit kulturor të pakicës rome. Konkretisht, në këtë dokument parashikohet zhvillimi dhe miratimi i një kurrikule të posaçme për mësimin e gjuhës rome në arsimin parauniversitar dhe atë universitar, me qëllim institucionalizimin e kësaj lënde brenda sistemit arsimor (masa 2.3, fq.103). Gjithashtu, plani synon përgatitjen e materialeve ndihmëse për mësues dhe nxënës, për të mbështetur përvetësimin e gjuhës rome dhe elementëve të historisë e kulturës së këtij komuniteti. Brenda objektivave të qarta të periudhës 2021–2025, parashikohet që kurrikula për gjuhën rome të miratohet zyrtarisht dhe të përfshihet në mënyrë të rregullt në programet arsimore.

Ky kuadër politik dhe strategjik krijon një mjedis mbështetës, por sfida mbetet në zbatimin konkret, siç ilustron nga rasti në fjalë, e siç do të analizohet në vijim.

Analiza e rastit

Avokati i Popullit vlerëson se rasti në fjalë nxjerr në pah një sërë çështjesh të rëndësishme lidhur me të drejtat e pakicës rome për arsimim në gjuhën amtare dhe funksionimin e mekanizmave shtetërorë në garantimin e këtyre të drejtave.

E drejta për arsimim në gjuhën amtare është një garanci thelbësore për ruajtjen e identitetit etnik-kulturor dhe mbrohet si në legjislacionin shqiptar, ashtu edhe në konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave. Mospasja e mundësisë për të mësuar dhe praktikuar

gjuhën amtare në shkollë mund të kontribuojë në asimilimin e padëshiruar të pakicave ose ndjenjën e përjashtimit nga kultura e tyre. Nga ana tjetër, ofrimi i mësimi të gjuhës rome në shkollë ose në kuadër të programeve të strukturuar do të kishte efekt pozitiv jo vetëm në ruajtjen e gjuhës, por edhe në rritjen e vetëbesimit të fëmijëve romë, në rritjen e pjesëmarrjes së tyre arsimore (duke e bërë shkollën një mjedis më të afërt me identitetin e tyre) si dhe në ndërgjegjësimin e gjithë komunitetit shkollor mbi vlerat e diversitetit kulturor e gjuhësor. Më tej, rasti i 17 të rinjve romë nga zona që kanë përfunduar studimet e larta, i cili përmendet në kronikën nga e cila Avokati i Popullit mori dhe iniciativën për ndjekien e këtij rasti, tregon se kur komuniteti i jepet mbështetje dhe motivim, rezultatet në arsim dhe integrim mund të jenë pozitive.

Nga njëra anë, Plan i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve parashikon në mënyrë të qartë dhe ambicioze masa konkrete për ruajtjen e gjuhës rome, përfshirë zhvillimin dhe miratimin e një kurrikule të posaçme, përgatitjen e materialeve ndihmëse për mësues dhe nxënës, si dhe institucionalizimin e mësimi të gjuhës rome në sistemin arsimor parauniversitar dhe universitar deri në vitin 2025. Këto janë objektiva të qarta, të cilat e pozicionojnë mësimin e gjuhës rome si një përbërës thelbësor të integritit dhe përfshirjes arsimore të komunitetit rom. Nga ana tjetër, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), në përgjigjen e saj zyrtare, konfirmon angazhimin e përgjithshëm ndaj arsimimit të pakicave, por nuk paraqet asnjë hap konkret të ndërmarrë për zbatimin e këtyre masave, as për miratimin zyrtar të kurrikulës dhe as për përhapjen e saj. Përkundrazi, thekson se deri tani nuk ka pasur asnjë kërkesë që përmbush kriteret ligjore për hapjen e klasave në gjuhën rome, duke e vendosur përgjegjësinë thuajse ekskluzivisht tek komuniteti ose pushteti vendor.

Avokati i Popullit vlerëson se në këtë aspekt ka hendek midis angazhimeve politike-strategjike dhe praktikës institucionale, mungesë të një mekanizmi efektiv zbatimi, si dhe një qasje që më shumë justifikon mosveprimin sesa e orienton procesin drejt zgjidhjeve konkrete.

Për më tepër, referimi strikt ndaj kriterëve të VKM nr. 1155/2020 – si pragu i 20% të popullsisë dhe kërkesa formale nga komuniteti, ndonëse ligjërisht korrekt, nuk përputhet me frymën e Planit të Veprimit, i cili kërkon masa pozitive dhe fleksibilitet institucional, veçanërisht për komunitete të shpërndara dhe më pak të organizuara si ai rom. Në këtë mënyrë, Ministria rrezikon të kthejë një instrument gjithëpërfshirës si plani, në një dokument formal pa ndikim real në terren.

Ky rast tregon se brenda komunitetit rom ekziston një nevojë dhe dëshirë për ruajtjen dhe mësimin e gjuhës amtare. Fakti që rreth 23 fëmijë ndjekin këto mësim informale tregon interesimin dhe mbështetjen e prindërve romë për ruajtjen e gjuhës së tyre. Nga informacionet e marra rezulton se deri tani nuk është ndjekur asnjë procedurë formale për hapjen e një klase ose programi mësimor në gjuhën rome në zonën e Fierit. Asnjë kërkesë e komunitetit apo vendimmarrje e autoriteteve vendore nuk është regjistruar, kjo ose për shkak të mungesës së

informacionit tek komuniteti për të drejtat e tyre në arsimimin në gjuhën amtare, ose si pasojë e mungesës së proaktivitetit nga autoritetet lokale për të identifikuar nevojat e këtij komuniteti. Vetë institucionet lokale (bashkia, ZVA) duket se nuk kanë ndërmarrë iniciativa vullnetare për të ofruar mësim plotësues ose për të nxitur përdorimin e gjuhës rome në shkolla, ndoshta duke u justifikuar me mungesën e një kërkesë formale ose me vështirësitë për plotësimin e kriterëve ligjore.

Legjislacioni aktual kërkon që pakica kombëtare të përbëjë të paktën 20% të popullsisë së njësive administrative që të arrihet hapja e klasave në gjuhën amtare. Në praktikë, komuniteti rom në Shqipëri shpesh nuk e arrin këtë përqindje në shumicën e njësive administrative, pasi romët zakonisht janë më të shpërndarë gjeografikisht ose në numër më të vogël krahasuar me pakicat e tjera historikisht të pranishme në zona kompakte (si pakicat greke apo maqedonase). Për rrjedhojë, edhe në rastin e Fierit, është e mundur që përqindja e popullsisë rome në Mbrostar apo Baltëz të jetë nën pragun e kërkuar ligjor.

Ky prag është konceptuar si një garanci marrë parasysh burimet njerëzore, infrastrukturore dhe organizative që kërkon ofrimi i arsimit në një gjuhë të dytë brenda sistemit publik. Megjithatë, kjo dispozitë nuk duhet të interpretohet si një ndalim absolut për mësimin e gjuhës së pakicës nëse përqindja është më e ulët. Përkundrazi, ajo përcakton një detyrim pozitiv për autoritetet publike kur pragu 20% është i arritur, por nuk përjashton veprimin fleksibël apo të pilotuar (testuar) në rastet kur ky prag nuk përmbushet. Në këtë kuptim, për situata si ajo e komunitetit rom në zonën Mbrostar-Baltëz, ku numri i fëmijëve romë është i konsiderueshëm, por mund të mos arrijë 20% të popullsisë së njësive administrative, mundësi i mësimin të gjuhës rome, edhe në forma alternative si kurse pas mësimin, klasa fakultative ose aktivitete përmes shkollave qendra-komunitare, do të përbënte një praktikë të mirë, në përputhje me parimin e gjithëpërfshirjes dhe mbrojtjes së identitetit kulturor të pakicave.

Për më tepër, Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, të cilën Shqipëria e ka ratifikuar, pranon përdorimin e kriterëve sasiorë për ushtrimin e të drejtave gjuhësore, por paralajmëron që këto kriterë nuk duhet të bëhen pengesë për ushtrimin efektiv të të drejtave, veçanërisht kur kemi të bëjmë me pakica të shpërndara ose më të vogla në numër. Neni 14, pika 2 e kësaj Konvente parashikon: *2. Në zonat ku personat që i përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht apo në numër thelbësor, në se ka një kërkesë të mjaftueshme, Palët do të përpiqen të sigurojnë, për aq sa është e mundur, dhe në kuadrin e sistemeve të tyre arsimore, që personat që i përkasin këtyre pakicave të kenë mundësi të përshtatshme për të mësuar gjuhën e pakicës apo për të marrë mësim në këtë gjuhë.*

Në këtë frymë, autoritetet shtetërore, si pushteti vendor, institucionet arsimore dhe vetë MAS - mund dhe duhet të ndërmarrin veprime pozitive, edhe përtej detyrimeve minimale ligjore, për të promovuar mësimin e gjuhës rome aty ku ka interes dhe nevojë të shprehur. Kjo qasje do të ishte në përputhje me objektivat e Planit Kombëtar të Veprimit për përfshirjen e romëve dhe

egjiptianëve dhe me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, të cilat theksojnë domosdoshmërinë e krijimit të një sistemi arsimor të ndjeshëm ndaj diversitetit kulturor dhe gjuhësor.

Për rrjedhojë, ndërsa pragu 20% e popullsisë mbetet një kusht për detyrimin institucional, çdo përqindje më e ulët nuk e përjashton mundësinë për veprim, që rastin e komuniteteve të vogla si ai rom - është edhe më e domosdoshme. Zgjedhja për të mbështetur mësimin e gjuhës rome edhe në këto rrethana do të përbënte një model pozitiv për mbrojtjen e të drejtave të pakicave në praktikë, dhe një tregues real të angazhimit kundrejt gjithëpërfshirjes dhe barazisë.

Ligji i ngarkon njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) me një rol të rëndësishëm në nismën për arsimimin në gjuhën e pakicave. Në këtë rast, duket se Bashkia Fier nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim, as para e as pas publikimit të rastit në media. Madje, mungesa e përgjigjes ndaj kërkesës së Avokatit të Popullit tregon mospërfshirjeje ose mungesë prioriteti të kësaj çështjeje në agjendën e pushtetit lokal, duke mos adresuar me seriozitet dhe ndjeshmëri çështjet e arsimit dhe kulturës së pakicës rome në nivel vendor. Nga ana tjetër, shqetësues është dhe fakti që ky aktivitet është zhvilluar plotësisht jashtë sistemit zyrtar, duke qënë se si Zyra Vendore Arsimore (ZVA Fier) ashtu dhe DRAP Fier u shprehën të painformuara për ekzistencën e nismës së mësuesit rom. Ndërkohë, asnjë program shtetëror specifik nuk është ofruar për këta fëmijë, çka sugjeron mungesë të koordinimit midis institucioneve dhe komunitetit, si dhe nevojën për kanale komunikimi më efektive ku komunitetet pakicë të mund të artikulojnë kërkesat dhe nevojat e tyre.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit sugjerojnë se shkollat që funksionojnë si qendra komunitare mund të shërbejnë si hapësira ku mund të zhvillohen aktivitete kulturore dhe mësimore në gjuhën rome (p.sh. kurse pas mësimi, klube gjuhe, etj.), me kusht që të ketë interes të shprehur. Kjo është një mundësi konkrete që mund të realizohet pa hyrë në procedurat më të ndërlikuara të hapjes së klasave dygjuhëshe zyrtare. Në Fier ka gjasa që disa shkolla (sidomos ato në zonat me popullsi rome) të kenë statusin e qendrës komunitare; aty mund të ofrohen kurse të gjuhës rome në orare pas mësimi, duke angazhuar vetë individë të kualifikuar nga komuniteti, me mbështetjen e institucioneve arsimore.

Pavarësisht vullnetit të mirë dhe nevojës së komunitetit, mungesa e procedurave të ndjekura formalisht dhe ndoshta vështirësia për të përmbushur kriteret ligjore, kanë bërë që mësimi i gjuhës rome të mbetet një nismë private dhe e paformalizuar. Kjo situatë kërkon vëmendje të posaçme, me qëllim që iniciativa pozitive e komunitetit të mos shuhet, por përkundrazi të mbështetet dhe integrohet në sistemin arsimor në mënyrë të qëndrueshme.

Konkluzione dhe rekomandime

Avokati i Popullit vlerëson se e drejta e fëmijëve romë për arsimim në gjuhën e tyre amtare nuk po gjen zbatim praktik në rastin konkret, duke cënuar potencialisht ruajtjen e identitetit gjuhësor dhe kulturor të komunitetit, e duke sjellë mangësi në përmbushjen e detyrimeve të shtetit shqiptar ndaj pakicave kombëtare, detyrime këto të parashikuara si nga ligji i brendshëm ashtu edhe nga konventat ndërkombëtare që vendi ynë ka ratifikuar.

Sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, në vijim të nenit 2 të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se *“Avokati i Popullit .. është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend”* si dhe të nenit 21/b, ku thuhet shprehimisht se *“pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime: ... paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut...”*.

R E K O M A N D O J M Ë:

1. Marrjen e masave të nevojshme nga Bashkia Fier për vlerësimin e nevojave arsimore të komunitetit rom në territorin e saj.
2. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) të konsiderojë fleksibilitetin e kriterëve ose ofrimin e zgjidhjeve alternative për arsimimin në gjuhën amtare të pakicës rome.
3. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), në kuadër të zbatimit të Strategjisë 2021–2026, të mundësojë përgatitjen e teksteve apo udhëzuesve për mësimin e gjuhës rome.
4. Zyra Vendore Arsimore (ZVA) Fier dhe Drejtoria Rajonale Arsimore të nxisin më tej komunikimin dhe ndërgjegjësimin brenda komunitetit rom lidhur me të drejtat arsimore.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se: *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*, lutemi, pas shqyrtimit, të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA

d.v.